



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 22
Prishtinë, më 15.9.2015, në orën 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

PROCESVERBAL

I Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, kryetare, Salihe Mustafa, Slavko Simiq, Mexhide Mjaku-Topalli, Etem Arifi, Mytaher Haskuka, Teuta Haxhiu, Valdete Bajrami dhe Kujtim Paçaku.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Reshit Gashi, koordinator i Komisionit, Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Kaltrina Ahmeti-GLPS, Lejla Selimi-OSBE, Bardhë Shkreli-RTK Radio, Besmir Kokollari-Instituti ICHAT, Basri Berisha-IAP dhe Mergime Kajtazi-KDI.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nr. 20 dhe nr. 21;
3. Rishikimi i Planit të punës për 2015;
4. Shkresa e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Kadri Veseli, për shqyrtimin e Kërkesës së zv. Avokatit të Popullit, Bogojub Staletoviqit;

5. Përgatitjet për mbajtjen e Tryezës së rrumbullakët: “Barazia gjinore në institucionet e Kosovës”;
6. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshim.

2. Miratimi i procesverbaleve nr. 20 dhe nr. 21

***Kryetarja-** konstatoi se procesverbali nr. 20 i mbledhjes së mbajtur me dt. 15 korrik 2015 u miratua pa vërejtje.*

Mytaher Haskuka-Tha se ka vërejtje në procesverbalin nr. 21, të mbledhjes së mbajtur më 22 korrik 2015, te rekomandimet e monitorimit të Ligjit për Personat e Verbër, ka thënë se duhet cekur se cilat nene duhet të ndryshohen, dhe cilat nene duhet të zbatohen, p.sh. te neni 7.3 nuk theksohet se a duhet ndryshohet e plotësohet apo duhet të zbatohet, këto çështje duhet të qartësohen në raport.

***Kryetarja-** konstatoi se procesverbali nr. 21 i mbledhjes së mbajtur me dt. 22 korrik 2015 miratohet me vërejtjet e deputetit Mytaher Haskuka.*

3. Rishikimi i Planit të punës për 2015

Kryetarja- Tha se meqenëse filluam sesionin vjeshtor po bëjmë edhe rishikimin e Planit të Punës për vitin 2015. Planin e Punës e keni para vetes dhe përmbledhjen me pikat e punëve që kanë mbetur pa u realizuar, çështjet që i kemi në vazhdim, si dhe bartjen e çështjeve për sesionin vjeshtor.

Ajo tha se dy projektligje që kemi pasur me i shqyrtua në sesionin pranveror, nuk kanë arritur të procedohen nga Qeveria me kohë dhe ende nuk janë proceduar në Kuvend. Këto barten për sesionin vjeshtor dhe jemi të gatshëm të punojmë kurdo që procedohen.

Sa i përket vizitave nëpër njësitë komunale ato mbeten të realizohen tani në sesionin vjeshtor, po ashtu edhe miratimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Personat e Verbër dhe Udhëzuesit për shqyrtimin e Peticioneve.

Kujtim Paçaku- Tha se dua të ndërlidhem me vizitat që po bëhen nëpër njësitë komunale për të Drejtat e Njeriut, dhe tani po planifikohet vazhdimësia e këtyre aktiviteteve. Ne deri me tani kemi vizituar katër komuna: Gjakovën, Graçanicën, Gjilanin dhe Ferizajn. Qysh në takimin e parë kemi arritur ta formojmë një radio në gjuhën rome në Gjakovë dhe këtë e konsideroj shumë të suksesshëm dhe është në favor të komunitetit, dhe është bërë një sensibilizim i mirë, dhe është mirë me qenë nëpër takime i gjithë njësi për të drejtat e njeriut, e jo vetëm komiteti për komunitete, dhe mu realizuar edhe vizitat nëpër komuna të tjera.

Kryetarja- Tha se është mirë nëpër këto vizita të jetë prezent edhe kryetari apo nënkryetari i komunës dhe të ketë vizita nëpër komunat kufitare, sepse ato komuna ballafaqohen me probleme të ndryshme.

Valdete Bajrami- Pyeti se këto pika që u diskutuan për rishikimin e Planit të Punës a do të inkorporohen në Planin aktual.

Kryetarja- Tha se këto pika do të barten dhe plotësohet plani aktual për këta muaj që kanë mbetur.

Teuta Haxhiu- Tha se sa ju përket vizitave nëpër njësitë komunale për të drejtat e njeriut, kemi pasur ankesën e një zyrtareje nga njësi për Barazi Gjinore e komunës së Drenasit, dhe në kuadër të vizitave ta vizitojmë edhe komunën e Drenasit, dhe gjatë këtyre vizitave të bëhen përpjeke që nëse nuk e takojmë kryetarin, së paku të takojmë nënkryetarin e Komunës sepse është mirë të takojmë dikë nga stafi politik.

Sa u përket projektligjeve ajo tha se te Projektligji për liritë fetare, ajo qysh tash ka marrë ankesa prej disa bashkësive fetare dhe është mirë të mos ngutemi, të punojmë sipas kohës së caktuar dhe të bëjmë një ligj të mirë që shkon në favor të qytetarëve.

Salihe Mustafa- Fillimisht të gjithë komisionit ju dëshiroj suksese dhe punë të mbarë në këtë sesion, falënderoj administratën e komisionit që ka sjellë Planin e Punës dhe jemi këtu bashkë që të ndryshojmë dhe plotësojmë këtë plan varësisht nga agjendat dhe punët tjera që mund të vinë në ndërkohë, kështu që ju dëshiroj punë të mbarë së bashku në këtë sesion.

Mexhide Mjaku-Topalli- Tha se është me interes të dalim nëpër terren, vizitat që i kemi pasur nëpër komuna na kanë dhënë material me pa gjendjen se si është, çka punohet cilat janë kërkesat e qytetarëve e kështu me radhë, nuk kanë qenë komplet në takime njësi për të drejtat e njeriut, kanë munguar zyrtarët për barazi gjinore, për të drejtat e njeriut, por kryesisht jemi takuar me zyrtarët për komunitete, por shpresoj se koleget që janë nga ato vende do t'i plotësojnë këto vizita dhe do të kompletohemi me informata.

4. Shkresa e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Kadri Veseli, për shqyrtimin e Kërkesës së zv. Avokatit të Popullit, Bogojub Staletoviqit

Kryetarja- Tha se e kemi shqyrtuar ankesën e zv. Avokatit, kemi pasur në komision palët e involvuara në këtë proces, e dimë që lënda tani është edhe në gjykatë, ndërkohë është ripërsëritur kërkesa e tij dhe tani na vjen si shkresë e Kryetarit të Kuvendit për me shqyrtua këtë kërkesë.

Për shkak të respektimit të rregullores dhe afateve mendojë që është mirë me kërkuar interpretim nga komisioni për Legjislacion, për arsye se Kuvendi i Legjislaturës se katërt është shpërnda kur është bërë propozimi i Avokatit të Popullit për shkarkimin e zëvendësit.

Teuta Haxhiu- Tha se kjo lëndë është duke u zvarritur pa nevojë, përgjegjësia e jonë si komision është ta procedojmë për në Kuvend dhe atë për shkarkim, nuk kemi pse me kërkuar mendim nga komisioni për legjislacion. Me siguri komisioni është në dijeni për

këtë dhe ka pasur mundësi me dhënë mendim për këtë. Ne kemi material të mjaftueshëm që këtë lëndë ta dërgojmë në Kuvend dhe të vendosi Kuvendi.

Kryetarja- Tha se tani në komision po paraqiten dy propozime që të kërkohet një mendim nga komisioni për legjislacion dhe mendimi i deputetes Teuta që të procedohet për Kuvend.

Slavko Simiq- Tha se Bogoljub Staletoviq, që nga viti i kaluar në maj është i shkarkuar nga Avokati i Popullit dhe ne kemi pasur vakumin politik dhe kemi ngecur në shqyrtimin e çështjes së zëvendësavokatit, dhe rasti i tij ka ngecur pa ardhur ende në Kuvend. Ne kemi dëgjuar argumentet e Avokatit të Popullit dhe të z. Staletoviq, pajtohemi që mos të kërkohet mendim nga Komisioni për legjislacion, por të vendosim që kjo lëndë të procedohet në Kuvend, dhe kuvendi le të vendosë.

Mytaher Haskuka- Tha se ne, si komision, nuk mundemi me vendos për shkarkim apo jo, këtë e vendos Kuvendi, por ka pasur disa hapa që nuk kanë shkuar mirë.

Reshit Gashi- Tha se propozimi për shkarkim ka ndodhur kur Kuvendi ka qenë i shpërndarë dhe ndërkohë, në tetor zëvendësve ju ka skaduar mandati dhe kur ju ka skaduar mandati është problem dhe për këtë është mirë me dhënë mendim komisioni për legjislacion, për shkak se në kohën kur nuk ka mandat nuk i merret dhe nuk i jepet mandati dikujt. Komisionit nuk i ka arritur propozimi i avokatit sepse së pari duhet me u shqyrtuar propozimi i Avokatit, e pastaj ankesa e z. Staletoviq.

Teuta Haxhiu- Tha se ne, si komision, duhet me mbyllur këtë lëndë. Ne duhet me dërguar në kryesi, e ata le të vendosin se a e procedojnë për Kuvend apo jo.

Salihe Mustafa- Tha se kemi mbetur duke u sjellë në një rreth vicioz, i kemi të gjitha shkresat nga të dyja palët. Mendoj se nuk humbim asgjë me konsultuar Komisionin për legjislacion dhe dihet se mendimi i komisionit tonë procedohet për Kuvend.

Hetem Arifi- Tha se pajtohet që të kërkohet një interpretim nga Komisioni për Legjislacion dhe pastaj duhet të procedohet për Kuvend.

Mexhide Mjaku- Topalli - Tha se në takimet e më hershme kur e kemi trajtuar këtë çështje kam kërkuar që kjo lëndë të trajtohet edhe nga zyra ligjore e Kuvendit e pastaj ne të nxjerrim një përfundim. Më intereson të dijë se nëse e dërgojmë një material për mendim në Komisioni për Legjislacion a e dërgojmë propozimin e Avokatit të Popullit apo Ankesën e z. Staletoviq, ajo tha se kjo lëndë duhet të zgjidhet sepse jemi duke e trajtuar shumë gjatë.

Slavko Simiq- Tha se kur kanë filluar institucionet të funksionojnë është dashur me shqyrtua dhe të përgjigjemi menjëherë, këtë se kemi bërë dhe e kemi sjellë veten në një situatë që pala mundet me ngre padi kundër Kuvendit sepse çështja e ankuesit nuk është shqyrtua në kuadër të ligjeve dhe kohës, dhe tani duhet të intervenoj Kryetari i Kuvendit që ne e kemi vonuar marrjen e vendimit.

Teuta Haxhiu- Tha se komisioni me mendimin e zyrës ligjore ta procedojë këtë lëndë në Kryesinë e Kuvendit. Ne, si komision, duhet ta përmbyllim këtë lëndë.

Kryetarja- Tha se meqenëse me këtë preken edhe disa ligje tjera dhe duhet të shikohet një historik i kësaj çështjeje, sepse është edhe çështje afatesh, është mirë të konsultohemi me komisionin për Legjislacion sepse edhe neve na lehtësohen punët, e edhe për hir të korrektësisë.

Mytaher Haskuka- Tha se nuk e kam të qartë çka po e pyesim Komisioni për Legjislacion, se a ka pasur Avokati të drejtë për propozimin për shkarkim, apo se si të veprohet me këtë lëndë?

Kujtim Pacaku- Tha se kërkesa vije nga z. Staletoviq, dhe kërkon të shqyrtohet kërkesa e Avokatit të Popullit. Kërkesa e Avokatit është e njohur, ai duhet të thotë ankesën time, sipas mendimit tim ai duhet të bëjë ankesë.

Slavko Simiq- Pajtohem që duhet të bimë përfundime që të bëhen pagesat retroaktive dhe të bëhen edhe disa propozime dhe duhet të zgjidhet kjo, nuk duhet të zvarrisim lëndën duke kërkuar mendim nga komisioni për legjislacion.

Mytaher Haskuka- Tha se duhet procedohet kjo lëndë dhe mos të i shkelen të drejtat z. Staletoviq, sepse edhe ai ka të drejtë të dijë a është shkarkuar, apo jo, dhe pastaj mundet me kërkuar kompensimin përmes gjykatës. Vendimi i Avokatit të Popullit le të procedohet në Kuvend le të merret vendimi dhe në bazë të atij vendimi ai i realizon të drejtat e veta varësisht prej vendimit që merret.

Kryetarja konstatoi se Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

Komisioni vendosi që të kërkojë opinion ligjor nga drejtoria e përgjithshme për çështje ligjore dhe procedurale lidhur me procedimin e kërkesës se zv. Avokatit të Popullit, Bogoljub Staletoviq, për çështjet që janë me interes të sqarohen para procedimit të kësaj lënde. Komisioni deri në marrjen me shkrim të opinionit ligjor nuk mund të procedojë sipas kësaj lënde.

5. Përgatitjet për mbajtjen e Tryezës së rrumbullakët: “Barazia gjinore në institucionet e Kosovës

Kryetarja- Tha se në përputhje me planin e punës se 2015, edhe në mbledhjen e fundit kemi diskutuar për këtë çështje, mendoj që mbledhjen e radhës do t’i ftojme Agjencinë për Barazi Gjinore dhe Zyrën për Qeverisje të Mirë, që në mbledhjen e radhës të jenë prezent, sepse na ndihmon që në tryezë të paraqitemi më mirë dhe të diskutojmë për mbajtjen e tryezës. Ajo propozoi që orientimisht tryeza të mbahet me dt. 20 tetor 2015, por për këtë kemi kohë të vendosim.

6. Të ndryshme

Kujtim Pacaku- Tha se po e përcjell shqetësimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas, boshnjak dhe turk, për mos regjistrimin e studenteve të ri në Universitet, sepse kanë kuotën e rezervuar për tu regjistruar nëpër Universitete e Kosovës. Por kjo nuk është respektuar, nuk kemi problem në Prizren, kemi problem në Gjakovë kanë mbetur dy studentë të komunitetit të paregjistruar për ne janë sa dyqind. Rektorin nuk po mundemi ta takojmë, ministri i Arsimit nuk është në Kosovë, dhe kështu po humbasin studentet të drejtën e edukimit. Ai kërkoj që komisioni të përkrah me një rekomandim që t'i drejtohen universitetit, gjegjësisht senatit të Universitetit që të respektohet kuota e garantuar për këto komunitete.

Teuta Haxhiu- Tha se le të saktësohet saktë se ku e kanë të garantuar atë kuot dhe a kanë aplikuar në afatin e parë për regjistrim, sepse do të bëjë një pyetje për ministrin.

Mbledhja përfundoi në orën 13:40.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Lirije Kajtazi